



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 28 korrik 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:30

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm znj. Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës dhe anëtarët e KKSB-së: z. Bashkim Bajrami, komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z. Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimeh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z. Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së; Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesit e FSK-së z. Aldi Blyta dhe z. Arsim Qerimi, në zëvendësim të znj. Ilirianë Bunjaku dhe Përfaqësuesi i KFOR-it LMT z. Kovacs; znj. Arianita Rraci dhe z. Steffen Felbrich-UNMIK.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, materialet për mbledhje konsideroj i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.03.2025

U miratuan njëzëri

2. -Informatë e Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

-Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht fjalën ia kalojmë Komandantit të Stacionit të Policisë z. Bashkim Bajrami.

z. Bashkim Bajrami, theksoi, situata e përgjithshme e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë, është e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për përkeqësim të saj. Ka pasur numër të konsiderueshëm të rasteve të ndryshme të raportuara, por të cilat nuk kanë ndikuar në përkeqësimin e situatës së përgjithshme.

Fokusi ynë gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë sigurimi i një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët, parandalimi i kryerjes së veprave të ndryshme kriminale, arrestimi i personave që kanë kryer vepra të ndryshme apo kanë rënë ndesh me ligjin. Për të realizuar detyrat tona të përditshme në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, kemi planifikuar dhe organizuar plane të ndryshme operative qoftë në parandalim të aksidenteve të trafikut apo parandalimin dhe zbulimin e veprave të ndryshme penale.

Në aspektin e krijimit të një mjedisi më të qetë dhe ofrimit të sigurisë për qytetarët ne kemi në implementim strategjinë Policia në Bashkësi dhe Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca që nënkupton :

- Rritja e patrullimeve cilësore në Sektorë si dhe prezencës policore duke u angazhuar në Pika Kontrolli, Patrullime këmbë, Patrullime në vende të Frekuentuara, Patrullime në afërsi të institucioneve arsimore.

- Organizimi, implementimi i projekteve të përbashkëta me forumet e sigurisë KLSP, ESVB,

- Organizimi i takimeve me përfaqësues të fshatrave,

- Organizimi i takimeve me komunitetin kulturor, biznese,

- Organizimi i takimeve me kompanitë private të sigurimit fizik,

- Organizimi i takimeve periodike me DKA-në,

- Organizimi i debateve, tryezave, ligjëratave si dhe fushatave vetëdisuese lidhur me dukuritë negative,

Këto aktivitete zyrtarët tanë i kryejnë çdo ditë.

Nga Planet operative aktive në zbatim, kemi :

- Kontrolli i Shtuar i Trafikut në Qytet; Parandalimi, reagimi dhe hetimi i veprave penale kundër jetës dhe trupit; Parandalimi, luftimi i degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit në RKS; Gatishmëria vepruese-për kërcënimin me bomba; Lëmshëkërkuesit në Rugë; Unaza e Qelikët; Kulti Fetar; Siguria në Shkolla ; Parandalimi i veprave penale Vjedhje, Vjedhje rëndë dhe Grabitje; Ngritja e vigjilencës dhe shtimi i masave të sigurisë në Republikën e Kosovës, ndërsa prej Planeve më kryesore në këtë periudhë kemi: Sezona verore 2025 si dhe Parandalimi i veprave penale kundër pasurisë.

Te Plani -Siguria në shkolla, kemi një bashkëpunim të mirë me DKA- me të cilët kemi bërë plane të ndryshme për të parandaluar veprimtari të ndryshme që kanë qenë në kundërshtim me ligjin, që kanë qenë në afërsi të shkollave. Nga njësitë e zyrtarëve policorë që operojnë në afërsi të shkollave, kemi takime të rregullta me drejtorët dhe përfaqësuesit e shkollave, nga të cilët informohemi lidhur me situatën e përgjithshme. Njësitë tona mbajnë ligjëratat në vazhdimësi në shkolla. Ligjëratat janë pritur mirë si nga nxënësit, po ashtu edhe nga personeli arsimor i shkollave, janë mbajtur 12 ligjëratat deri në përfundim të viti shkollor, në gjashtë shkolla me gjithsej 2226 pjesëmarrës. Temat e ligjëratave kanë qenë: “Ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore”, “Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik” Ligjëratat janë mbajtur me nxënësit nga klasat e I –V- dhe VI – IX -ta.

Sa i përket incidentet e zjarrvënies gjatë kësaj periudhe kohore kemi në zbatim: Takimi i bazuar në Urdhërin Operativ Emergjent Zjarret e hapura ku kemi mbajtur takimin Sezona verore 2025 me datë 24/27.03.2025 në sallën e Kuvendit Komunal të Podujevës me: Drejtorin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural – KK-Podujevë; Drejtorin e Administratës KK-Podujevë; Drejtorin e shërbimeve Publike KK-Podujevë; Komandantin e brigadës së zjarrfikësve; Përfaqësues të fshatrave. Këto takime u organizuan me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të parandaluar zjarrvëniet e qëllimshme apo aksidentale si dhe parandalimin e të shtënave me armë në ahengje familjare.

Raste të lajmëruara deri më tani ku kemi pasur reagime janë 50 raste, prej tyre 08 janë dërguar në prokurori, me kallëzime penale, ku kryerësit e veprave penale janë të njohur, pastaj 21 kanë

mbetur në shënim zyrtar e që janë ende pjesë e hetimeve dhe 21 raste janë në raport të zyrtarit policor.

Përveç kësaj janë realizuar 79 urdhëresa gjyqësore, prej tyre 68 me gjobë, ndërsa 11 me burg; Sa i përket aksidenteve në trafik, kemi si vijon; Aksidente me fatalitet -01; Aksidente me dëme materiale -116; Aksidente me persona të lënduar - 26 (58 persona të lënduar); Mos ndalje në vendin e ngjarjes - 24.

Numri i përgjithshëm i kundërvajtjeve të shqiptuara nga kjo periudhë 27 Mars 2025 - 28 Korrik 2025 vetëm nga Stacioni jonë policor është 3952 kundërvajtje.

Nga rastet më të rëndësishme në kuptim të luftimit të dukurive negative shoqërore siç janë :Kafiteritë e natës, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozi të kundërligjshëm, ne kemi pasur angazhime në këtë drejtim dhe si nga informacionet tona po ashtu kemi pranuar edhe ankesat dhe si rrjedhojë kemi trajtuar: 57 raste të armëmbajtjeve pa leje, nga kapitulli i drogave kemi 29 raste të trajtuara, 50 raste të zjarrvënies, nga skemat piramidale dhe bixhozi janë të raportuara dhe të trajtuara 12 raste, te kapitulli i dhunës në familje kemi 24 raste të raportuara. Kjo ishte në pika të shkurtra statistikat rreth angazhimit policor dhe realizimit të planeve.

Konstatim: Kryetari për shkak të angazhimeve e autorizoi Nënkryetaren e Komunës znj. Marigona Lahu për vazhdimin e mbledhjes.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, meqë Kryetari që i detyruar të lë takimin për shkak të angazhimeve që ka, me kryesimin e mbledhjes do të vazhdoj unë. E falënderojmë komandantin për informatën, e hap debatin për atë që paraqiti Komandanti i Stacionit të Policisë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, ne vazhdimisht kemi diskutuar rreth organizimit ose Planit operativ i cili kishte për të trajtuar çështjen e pritjes së mërgimtarëve. Jemi në dijeni se fluksi i mërgimtarëve e vështirëson trafikun dhe ofron mundësinë që të ketë edhe probleme, incidente qoftë edhe të vjedhjes nëpër vetura apo diçka tjetër dhe lidhur me këtë kam një pyetje për Komandantin, se në bashkëpunim me Komunën, përkatësisht Drejtorinë përkatëse që e mbulon pjesën e trafikut, a ka ndonjë plan operativ që i dedikohet Podujevës, fjala është për plan të veçantë për të trajtuar çështjen e pritjes së mërgimtarëve.

z. Bashkim Bajrami, theksoi, ne kemi tri plane operative referuar bashkatdhetarëve, një për pritjen e tyre, të fluksit nga Merdari, Planin për sigurinë në trafik si dhe Planin për parandalimin e vjedhjeve nëpër shtëpi, ku kemi të angazhuar një njësi të veçantë, në këtë rast kemi edhe bashkëpunimin me Komunën ku na ka huazuar një veturë civile me qëllim të realizimit të planit.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, nëse dikush nuk ka diçka rreth informatës së Komandantit fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të KFOR-it për informatën lidhur me sigurinë në Komunë.

Përfaqësuesi i KFOR-it LMT z. Kovacs, theksoi, mirëmengjesi, faleminderit për ftesën, sa i përket punës tonë ne këtë e kryejmë sipas mandatit që derivon nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit dhe nuk ka ndryshuar asgjë sa i përket punës tonë. Ne e vëzhgojmë dhe monitorojmë situatën dhe sikurse e keni vërejtur ajo është e mirë dhe në rregull. Kjo është sa i përket raportimeve nga ana e KFOR-it. Sa i përket nivelit të përgjegjësisë së trupave të KFOR-it ne jemi përgjegjësi i tretë, pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Kjo është e tëra dhe nuk ka ndryshuar asgjë sa i përket punës tonë.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, e hap debatin lidhur me informatën e paraqitur nga ana e përfaqësuesit të KFOR-it.

z. Shemsi Jashari, theksoi, kam një pyetje sa i përket sigurisë, muajin e fundit kemi pas disa informacione dhe deklarime të Presidentes të Republikës së Kosovës që ka pas një rrezik potencial i cili është parandalua e që ka të bëjë me kufirin që Komuna e Podujevës e ka një pjesë

të madhe të kufirit me Serbinë, a ka diçka që mund të ndahet me ne dhe a ka ndonjë arsye për shqetësim të komunitetit, sidomos ai që jeton afër kufirit.

Përfaqësuesi i KFOR-it LMT z. Kovacs, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit për çështjen e sigurisë e gjithësesi me rolin tonë, trupave të KFOR-it, ju sugjeroj që ti drejtoheni Zyrës tonë që është për marrëdhënie me publikun, sepse në atë zyrë mund të merrni informacione të tjera. Kjo ishte e tëra sa i përket kësaj çështjeje.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, nëse nuk keni pyetje tjera atëherë po kalojmë te informata që duhet ta paraqes përfaqësuesi i FSK-së.

Përfaqësuesi i FSK-së tetar z. Arsim Qerimi, theksoi, shërbej në Njësinë e Operacioneve Speciale në Elementin e Çështjeve Civile. Fillimisht më lejoni për një falënderim të gjithë juve për kontributin që jeni duke dhënë për çështje më të rëndësishme për sigurinë. Nga monitorimet e përgjithshme që i bëjmë në nivel nacional ku përfshihet edhe Komuna e Podujevës vlerësojmë se situata është e qetë dhe stabile, përveç situatës së fundit që kemi me zjarret thuajse në tërë territorin e Kosovës, me të cilën jeni përballur edhe ju në ditët e fundit, ne si institucion shprehim gatishmërinë dhe jemi të gatshëm të ju ndihmojmë në çfarëdo situatë që përballët Komuna e Podujevës me gjithë personelin dhe kapacitete të cilat ne i posedojmë. Nuk dua ta zgjasë më shumë, juve ju dëshiroj suksese në punët dhe detyrat e juaja.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, e hap debatin lidhur me informatën e paraqitur nga ana e përfaqësuesit të FSK-së.

z. Bahri Selimi, theksoi, kam një pyetje konkrete për përfaqësuesin e FSK-së, meqë mund të të njoftoni pasi që jeni pjesë e KKS-së, sa FSK apo Njësia e juaj të cilën e përfaqësoni ka kapacitete për ndërhyrje në raste të emergjencave të cilat i përmendët edhe ju për shuarjen e zjarreve të shumta që kanë ndodhur, sepse nuk e di se sa jeni në njohuri, ne kemi bërë një kërkesë për mbështetje nga FSK, ditën e shtunë kur përballëshim me zjarrin dhe me temperatura shumë të larta dhe me hezitim duket se janë përgjigjur.

Përfaqësuesi i FSK-së tetar z. Arsim Qerimi, theksoi, Njësia jonë është urë ndërlidhëse me të gjitha institucionet civile, ku çdo informatë që ka nevojë të marr Shtabi, atë e merr nga ne. Ne jemi personat e parë që institucioni i qet në terren dhe bën vlerësimin e situatës. Sa i përket kapaciteteve, kemi diçka prej tyre, kemi Njësinë që shërben në kuadër të Gardës Kombëtare e cila posedon kapacitete të vogla, mirëpo përkundër kapaciteteve, vullneti është i madh për kryerjen e punëve, pra çka mund të them është se nuk ka hezitim sa i përket institucioneve të FSK-së, sepse jemi të gatshëm për të ndihmuar çdo herë në çfarëdo lloji situatë, pra këto situata di t'i kalojmë të gjithë së bashku me këto kapacitete që i kemi.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, nëse nuk keni dikush diçka tjetër rreth kësaj pike, e përmbylлим këtë pikë. Para se të kalojmë te pika e radhës do të propozoja që pikën 3 dhe 4 ti bashkojmë në një diskutim të përbashkët pasi që janë informata dhe ndërlidhen njëra me tjetrën dhe pas informatës së paraqitur nga Drejtori i DSHPMSH e hapim diskutimin.

Konstatim: Pas procesit të votimit u aprovua propozimi i Nënkryetares së Komunës që pika 3 dhe 4 e Rendit të ditës të bashkohet dhe të diskutohen si një pikë e vetme.

3. Informatë për planin e Reagimit Emergjent

4. Informatë nga SHZSH për intervenimet dhe gatishmërinë në rastet kundër zjarreve dhe intervenimet tjera

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, për këto dy pikat e rendit të ditës fjalën e ka Drejtori Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi, po paraqesim një raport të Planit Emergjent dhe Një Raport të Shërbimit të Zjarrfikësve përmes Komandantit të zjarrfikësve, i cili na ka siguruar të dhënat për angazhimet dhe intervenimet e kryera për periudhën gjashtë mujore të këtij viti. Në bazë të Planit Emergjent Operativ Lokal i cili është aprovuar në Kuvendin e Komunës më 28.12.2023 është paraparë funksionalizimi i Qendrës Operative lokale për raste emergjente. DSHPMSh në përballje me temperaturat ekstreme dhe rrezikun e shtuar nga zjarret ka aktivizuar Qendrën Operative Lokale duke ndërmarrë masa të menjëhershme për reagim dhe parandalim të rreziqeve. Masat e ndërmarra:

Aktivizimi i Njesisë profesionale të zjarrfikësve dhe shtimi i njësive të gatishmërisë;
Angazhimi i operatorëve ekonomik lokal që posedojnë mjete për shuarjen e zjarrit me pozicionimin e autocisternave në kryqëzimet në fshtat; Lluzhan Kërpimeh dhe Orllan;
Krijimi i linjave të koordinimit 24/7 nëpërmes njësive të emergjencës; policisë së zjarrfikësve dhe Qendrës operative;

Komuna e Podujevës në kuadër të angazhimeve për parandalimin e zjarreve ka ndërmarrë një sërë masa vetëdijësuese dhe organizative me qëllim përgatitjen e qytetarëve dhe institucioneve për reagim efektiv ndaj rreziqeve të shkaktuara nga zjarret. Janë organizuar shoqata vetëdijësuese në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Podujevës dhe përmes këtyre aktiviteteve nxënësit janë informuar rreth mënyrës së veprimeve në rastet e zjarreve, mënyrat e parandalimit dhe kontaktimit të shërbimeve emergjente me kohë. Përmes bashkëpunimit me mediat lokale dhe përdorimit të rrjeteve sociale si Facebook dhe Instagram janë publikuar njoftime dhe materiale edukative mbi rreziqet nga zjarri, si dhe udhëzime konkrete për qytetarët. Në kuadër të Planit Emergjent Operativ Lokal janë angazhuar të gjitha Drejtoritë relevante të Komunës për të koordinuar veprimet në rastet emergjente, këtu hyjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural , Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Arsimit. Këto Drejtori kanë për detyrë të kontribuojnë në aspektin organizativ logjistik, edukativ dhe financiar, duke bashkërenduar veprimet me Njësinë e Zjarrfikësve, Policinë, Qendrën Operative Lokale, qëllimi dhe krijimi i një sistemi funksional për parandalim, reagim dhe rehabilitim nga pasojat e shkaktuara nga zjarret. Kjo ishte e tëra sa i përket Planit Operativ, për detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Plani Operativ, ndërsa në vijim do ua paraqes raportin nga Njësia e zjarrfikësve për periudhën 01.01.2025- 21.07.2025. Sipas Raportit gjithsejtë janë realizuar 373 intervenime, krahasuar me 317 intervenime në të njëjtën periudhë në vitin 2024, duke paraqitur një rritje prej 17.6 %.

Struktura e intervenimeve për zjarre

22 raste objekte ndërtimore; 15 raste pajisje elektrike; 53 raste depo e mbeturinave; 135 raste në pyje shkurre dhe fusha dhe kullosa; 18 raste aksidente trafiku; 7 raste në ndërhyrje mjekësore dhe ndihma të ndryshme. Sipërfaqe të djegura gjatë kësaj periudhe 199.5 ha në pyje, 213.1 ha në fusha, 24 ha tokë bujqësore grurë, pemishte dhe perime. Kësaj shifre i shtohet edhe kjo shifra e fundit sepse raporti përfshinë periudhën deri më 21 korrik, ndërsa sikurse jeni në dijeni edhe ditën e premte dhe te shtunën jemi përballë me shumë zjarre , kështu që kësaj shifre i janë shtuar edhe 10 ha pisha në fshatin Kërpimeh që fatkeqësisht dhe e dhimbshme pasi që dyshohet si rezultat i faktorit njeri, përveç kësaj edhe 13 ha male janë djegur në ditët e fundit, shifër e cila duhet ti shtohet Raportit të shërbimit të zjarrfikësve.

Analiza dhe vlerësimi

Shumica e zjarreve janë shkaktuar nga pakujdesia e qytetarëve, e shpesh herë me qëllim ose si pasojë e përdorimit të teknikave të vjetra për pastrimin e kokave ose rigjenerimin e kullotave. Në shumë raste zjarret janë rezultat i konflikteve individuale ose hakmarrjes . Në këtë rast kërkohet rritje e bashkëpunimit me Policinë, pasi që shumë raste mbesin pa autor të identifikuar.

Theksohet mungesa e burimeve njerëzore dhe logjistike në Njësinë e Zjarrfikësve. Rekomandohet angazhim i përbashkët me Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , APK-në dhe Policinë për parandalimin, identifikimin dhe ndëshkim të shkaktarëve të zjarrit.

Rekomandime

Senzibilizimi i qytetarëve përmes fushatave, afisheve dhe aktiviteteve edukative; Tranime dhe pajisje shtesë për zjarrfikësit, gjë të cilën tashmë e kemi proceduar për pajisje dhe veshmbathje të zjarrfikësve, pra është lëndë në proces dhe shpresojmë së shpejti një kontingjent shumë i madh me pajisje dhe veshmbathje tash do të arrijë ; Rritje e vigjilencës dhe bashkëpunim më i mirë me Policinë për ndjekjen penale të personave përgjegjës; Mbështetje për shoqatat vullnetare të zjarrfikësve, sikurse jeni në dijeni tash së fundi me shumë mundim është formuar një shoqatë vullnetare e zjarrfikësve.

Në kuadër të kësaj bën pjesë edhe Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve dhe Fatkeqësive të tjera, i cili ka dalë në terren dhe është duke e përgatitur raportin final për dëmet e shkaktuara.

Si përfundim situata aktuale paraqet rrezik të shtuar për zjarret për shkak të temperaturave ekstreme dhe veprimeve të pandërgjegjshme të individëve. Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim me Njësinë e Zjarrfikësve po vazhdon të jetë në gatishmëri të plotë për të parandaluar, menaxhuar dhe eliminuar pasojat nga këto emergjenca.

Kjo është sa i përket Raportit.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, e hap diskutimin lidhur me raportin e paraqitur nga Drejtori Bahri Selimi.

z. Qefser Behrami, theksoi, unë dua të diskutoj lidhur me zjarr vënien në territorin e Komunës së Podujevës. Jam përfaqësues i fshatrave të rajonit të Kërpimehut dhe gjatë këtyre ngjarjeve rreth zjarreve tërë kohën isha prezent dhe kam parë situatën nga afër. Ndezja e zjarrit më datë 26 dhe 27 korrik nuk ka ndodhë në fshatin Kërpimeh por në fshatin Metehi. Një falënderim të veçantë kemi për zjarrfikësit për angazhimin e tyre. Zjarri dhe përhapja e tij ka qenë tmerruese dhe rrezik shumë i madh për rajonin. Por gjithashtu mirënjohje e madhe është edhe për banorët e fshatit sidomos të rinjtë që kanë qenë shumë aktiv dhe kanë dhënë kontributin e tyre. Për të përgatitur për këso situatash duhet bërë gati në muajin mars, pra duhet të jemi gati të gjithë në atë kohë. Këtu është edhe një problem tjetër shoqatën civile po e anashkalojmë , pse nuk punohet me ata njerëz pasi që ata kane shprehur vullnetin që në mënyrë vullnetare të angazhohen.

z. Shemsi Jashari, theksoi, nëse i referohemi raportit që dëgjuam faktikisht më shumë ngjanë si një deklaratë për publikun që e jep një zëdhënës, por ndoshta jo si një zyrtar përgjegjës për të trajtuar këtë temë. Raporti, nëse mundemi ti themi raport, në rend të parë ne vërejtjen që kemi bërë e që tash po përfundon mandati ynë, prej fillimi asnjëherë nuk është realizuar që ne ti kemi paraprakisht me material para se të vijmë në këto takime, fjala vjen nëse informata është e gatshme kur ftohet mbledhja ne duhet të dimë se çfarë ka në atë informatë për të pasur mundësi ta analizojmë në mënyrë që të japim kontributin tonë, e ajo s'po ndodhë e nuk ndodhi as sot. Po flasim për qindra hektar të djegur pyje e fusha, tash 10 ha pisha, e rrezikim të pronave dhe shtëpive, e çka është më e rëndësishme rrezikim i jetëve. Si komunë në këtë rast dhe si shtet në përgjithësi ne ende po flasim me fjalët e njëjta që kemi folë në vitin e kaluar por edhe para vitit të kaluar, me një Njësi të Zjarrfikësve që ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe teknike që ende nuk ka një palë shkallë për ngjitje deri në katin e 3 apo 4 nëse paraqitet nevoja, dhe po flasim për rastet e fundit që raportet tregojnë ka pas mungesë të ujit , hidranti në Qendrën e zjarrfikësve nuk ka pas ujë kur ka arritur automjeti i zjarrfikësve të mbushet, dmth është dashur të merresh edhe me tema më bazike që hidranti kur duhet për ti furnizuar kamionët me ujë dhe për të shkuar në intervenim në vatër të zjarreve, nuk ka pasur ujë. Po flasim për një injorim që i është bërë kësaj problematike dhe tashmë thjesht jemi shndërruar në një grup që thjesht po konstatojmë, po grumbullojmë statistika dhe asgjë s'po bëjmë. Kemi pas propozime konkrete që bujqit që

përfitojnë prej subvencioneve tu tërhiqet vërejtja që nëse ata janë shkaktarë për djegien e atyre hapësirave çoftë për t'i pastruar sipas metodës së vjetër që i kemi përjetuar, të jetë shkak për mos marrjen e subvencioneve, sepse shteti jep subvencion ndërsa fermeri po shkakton rrezik të përgjithshëm. Dëgjova se ka pas ligjërata me fëmijë, por fëmijët nuk i djegin arat, po nisem nga fëmijët e mi të cilët fare nuk e dinë se ku janë arat, po flasim për një kategori tjetër. Mirë është t'i edukojmë fëmijët për zjarret dhe si mos ti ekspozohen rrezikut, mirëpo po flasim për një kategori të bujqve që veç me ta duhet të merremi. Ne sot lagjeve kemi shumë pak fëmijë që i shohim qoftë edhe duke lozur e jo të dalin dhe të ndezin arat. Pra po flasim për kategorinë që merret me punë bujqësore dhe këtu kemi telashet. Unë nuk dëgjova që Komuna ka subvencionuar diçka, ndihmuar apo dhuruar diçka si donacion apo çfarëdo forme ligjore. Njësinë e Zjarrfikësve prej vitit të kaluar, për të pasur mundësi ata të shtojnë kapacitetet. Çka mund të bëjnë 4 zjarrfikës kur gjysma e Llapit është në flakë, jam në dijeni që është kompetencë edhe e Nivelit qendror por për fatin e juaj Niveli qendror dhe lokal janë të të njëjtit subjekt dhe ato pengesat për inate politike nuk është dashur të jenë, për të shtuar kapacitetet.

z. Shefki Selmani, theksoi, desha të shtoj diçka më shumë nga ajo që theksoi z. Shemsi Jashari rreth ujit, për situatën që jemi sot dua të shtroj një pyetje se a duhet të ndalet uji në rrethana të tilla kur familjarët janë të vetmit që mund ta mbrojnë shtëpinë e vet nga zjarri, ndërsa ata nuk kanë ujë dhe atë prej orës 08 në mëngjes deri në 10 të natës, pra ata nuk kanë mundësi vet të mbrojnë shtëpinë e jo zjarrfikësit që janë duke shkuar në gjithë ato zona ku janë duke u djegur pyjet apo fushat. Si është e mundur të lejohet që uji të qarkullojë apo të ketë vazhdimisht sidomos gjatë këtij sezoni ku ka rrezik të djegies shtëpive apo pronat e njerëzve ku kanë arat me grurë apo misër.

z. Bahri Selimi, theksoi, do të mundohem në çështjet e ngritura të përgjigjem edhe pse raporti sikurse e potencoi z. Shemsi Jashari paska qenë më shumë si komunikatë e paraqitur nga unë si zëdhënës. Realisht me gjithë ato të dhëna ai është raport me të dhëna të sakta të cilat vijnë nga vendi i ngjarjes dhe nga Njësia përgjegjëse, por sido që të jetë vlerësojeni si të doni. Sa i përket mungesës së ujit, kjo është pak shqetësuese dhe vlen si përgjigje për të dy që parashtruan këtë çështje. Për shkak të reduktimeve që bëhen në disa pjesë të Komunës, siç kemi edhe informacionet nga KRU Prishtina sepse sikurse jeni në dijeni si për reduktime, mirëmbajtjen e rrjetit dhe zgjerimin e rrjetit është në kompetencë të KRU Prishtinës, mirëpo sipas njoftimeve nga ana e tyre janë duke bërë reduktime në mënyrë që të ketë ujë të mjaftueshëm gjatë kësaj kohe me temperatura të larta. Mirëpo pjesërisht në pamundësi të ketë rregullisht 24 orë ujë ata obligohen që të bëjnë reduktime sipas një forme të rrotacionit në mënyrë që të gjithë qytetarët të jenë të përfshirë me furnizim me ujë të pijes, por e keqja është se nuk ka ujë të mjaftueshëm 24 orë, por e mira e kësaj është që po aplikohet furnizimi sipas rrotacionit me orare të caktuara. Sa i përket ndaljes së ujit në Njësinë e Zjarrfikësve kjo është e vërtetë, por pa ndonjë qëllim të caktuar, sepse kur është bërë reduktimi i ujit në atë pjesë në atë rrejt është i lidhur edhe objekti i Njesisë së Zjarrfikësve, pra hidranti ku ata furnizohen. Në këtë rast unë jam njoftuar menjëherë nga Zjarrfikësit dhe unë kam komunikuar me menaxherin e ujësjellësit dhe kjo ka ndodhë në orët e vona, ndoshta rreth orës 22:00 dhe pas intervenimit uji është lëshuar menjëherë në atë pjesë dhe në pamundësi që ti lëshohet uji vetëm objektit të Zjarrfikësve uji është lëshuar për tërë atë pjesë dhe është bërë një farë rregullimi të reduktimeve që kanë qenë të caktuara, mirëpo kjo mungesë e ujit në hidrant ka ndodhë maksimumi 10 min si më është raportuar, dhe nuk ka pas më probleme. Te vetëdijesimi i fëmijëve nëpër shkolla, ky është një projekt i cili është bërë në bashkëpunim me AME-në, OSBE dhe me Zjarrfikësit, ku ka qenë përfshirë edhe Komuna, andaj nuk pajtohem që fëmijët nuk duhet të vetëdijesohen, sepse zjarr vëniet më të shpeshta janë prej fëmijëve dhe këtë e bëjnë nga pakujdesia dhe për këtë arsye kemi filluar me angazhimin për vetëdijesimin fillimisht prej gjeneratave të reja. Me procesin e vetëdijesimit mendoj se është bërë

një punë shumë e mirë dhe mendoj se duhet vazhduar me trajnime dhe ligjërata edhe nga zjarrfikësit ashtu edhe nga Policia e Kosovës e cila mban ligjërata të shumta nëpër shkolla sepse aty fillon brezi i edukimit. Kur jemi te pajisjet e Zjarrfikësve ne e kemi diskutuar shumë herë çështjen e kompetencës apo të konfliktit të kompetencave mes AME-së dhe Komunave edhe kjo çështje është në proces të zgjidhjes sepse Ligji që e rregullon këtë çështje është në proces të amandamentimit, megjithatë ne si Komunë kemi marrë si iniciativë për ndarje të një pjese të buxhetit për t'i pajisur me veshmbathje dhe uniforma duke filluar prej veshjes/trenerkave sportive deri te uniforma për fikjen e zjarrit por edhe me pajisje të cilat ata i kanë specifikuar në kuadër të listës për furnizim. Secilin mjet të nevojshëm për zjarrfikësit që komandanti i Njësisë e ka sjellë në DSHPMSh si kërkesë, të gjitha janë përfshirë në kontratë. E keqja e kësaj është se ka pas ankesa dhe është vonuar pak kontrata sepse ky aktivitet është bërë në fillim të vitit, por fatkeqësisht nganjëherë këto procedurat e prokurimit reflektojnë në ngadalësimin e projektit. Në kuadër të kontratës si pajisje ka pompa me ajër, aparat elektrik, shkallë dhe pajisje të ndryshme etj. Shpresojmë se do të përmbyllet edhe periudha e ankesave dhe zjarrfikësit të paktën të kenë një mundësi më shumë, përkundër numrit të vogël që e kemi cekur shumë herë. Tashmë së fundmi janë rekrutuar dy zjarrfikës të rinjë, dhe ky rekrutim është bërë nga AME pasi që është në kompetencë të këtij institucioni, por prapë se prapë numri i zjarrfikësve është i pa mjaftueshëm krahasuar me numrin e banorëve që ka Komuna e Podujevës.

z. Shemsi Jashari, theksoi, këtë që të bën, me diskutuar me politikan është problem se e shohin politikisht më shumë se teknikisht dhe praktikisht një problem. Theksova se mirë është me fëmijët me i mësuar se si të ruhen apo evitohen rrezikut, por nuk është targeti fëmija por bujqit. Asnjë takim nuk e keni në asnjë fshat ku i thirrni banorët, kurdo që i thirrni për fushata për tu ulur për të diskutuar, dhe duke u thënë se po hyjmë në sezonin ku zjarret shkaktohen dhe ju duhet të jeni të kujdesshëm dhe për të shpërndarë edhe broshura dhe veprimet 1,2,3, që duhet ndërmarrë, asnjë nuk është bërë. Nuk janë shfrytëzuar mundësitë tjera, për shkak se keni bllokuar themelimin e Këshillave lokale, pasi që filloi si proces, dhe tash keni një mekanizëm minus, sepse do të mund të shfrytëzohej në parandalimin e kësaj dukurie. Zjarre do të ketë, ka edhe në Amerikë, por do të kishin për të qenë më të menaxhuara dhe më herët të identifikuar, por asnjë veprim nuk është bërë. Do duhej shfrytëzuar mundësitë në ditët e Xhumasë, ditëve të premte ku ka prezencë të madhe të qytetarëve të moshës madhore që i frekuentojnë Xhamitë për të shpërndarë broshura, ose për të lutur imamët që t'i paralajmërojnë dhe për t'i vetëdijesuar, e kjo para se të ndodhin. Këtu në këtë takim nuk dëgjova asnjë veprim konkret që ju si Komunë e keni bërë, Policia kryen punën e vet në kuadër të mandatit që ka, edhe Zjarrfikësit ata që janë numër dalin dhe kryejnë punën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa ju si Komunë çfarë keni bërë për këtë punë, dhe për fat të keq rezulton se asgjë nuk keni bërë. E theksoni se keni përmbushur kërkesat e Zjarrfikësve dhe i keni përfshirë në kontratë. Po flasim për vitin e katërt, po i referohem vetëm mandatit që unë jam këtu, për çdo vit është thënë nga ju se jemi duke identifikuar, e kemi në proces, e kemi konstatuar dhe e kemi me bërë, kemi me bërë, dhe në fund jeni hy në fushatë zgjedhore tash dhe prapë po thoni kemi me bërë. Kjo kemi me bërë po mendoj është një deklaratë e mirë, mirëpo nuk është se po kryen punë, bëne ma çka po pritni, kush është duke ju ndalur, vet e keni buxhetin. Unë kam dëgjuar Kryetarin në një intervistë ku thotë që janë bërë 250 milion investime në Komunën e Podujevës, bartni ndonjë shumë te Zjarrfikësit, nja 2000 €. Ata kanë nevojë për trenerka për pjesën rekreative por kanë më shumë nevojë për njerëz, për pajisje, për shkallë. Pa dashur ta zgjas, me kthye këtë në debat pro dhe kundër, ju si Drejtor a mund të na tregoni veprimet me 1,2,3 me çka konkretisht e keni mbështetur Njësinë e Zjarrfikësve në kuptimin me i ndihmua për kryerjen e punës që kanë.

z. Bahri Selimi, theksoi, më vije keq që duhet të përsëris gjërat, sepse ose nuk po i kupton apo nuk don t'i kuptosh, e para, e dyta problemi i komunikimit me politikan është e vërtetë se është

pak problem sepse ti nuk ke njohuri të mjaftueshme për punët që bëhen, andaj edhe kërkon nga 2-3 herë për t'i shpjeguar gjërat. Unë theksova shumë qartë se çfarë kemi bërë, trajnimi vetëdijësues është organizuar me Komunën ku kanë qenë të përfshirë edhe zyrtarë të Komunës që nuk janë zjarrfikës por zyrtar për emergjenca, Zjarrfikësit, AME . Sa i përket rritjes së stafit, kjo është bërë me kërkesë të Komunës, fjala është për dy zjarrfikësit e rekrutuar tashmë, pra ky është hap që është bërë nga ne. Kemi kërkuar të rekrutohen më shumë por kaq kanë pas kapacitete për këtë vit. Ne në vazhdimësi kemi kërkuar për rritjen e numrit dhe e dimë saktësisht sa duhet të jetë numri i zjarrfikësve në Komunën tonë, referuar kriterit të numrit të popullsisë. Hap tjetër është kjo për veshmbathje dhe pajisje, gjë që nuk na takon neve por AME-së, mirëpo kur e kemi parë se AME nuk po ka mundësi ta bëjë këtë kemi marr hapa vet në këtë punë dhe kemi ndarë mjete për blerjen e pajisjeve dhe lënda është në procedurë të prokurimit dhe sikurse edhe ju jeni në dijeni procedurat mund të na vonojnë dhe të zgjasin shumë. Pra ne edhe pse nuk ka qenë në përgjegjësinë tonë kemi ndarë buxhet për pajisje të tyre . Po ashtu një kamion të madh me shkallë na kanë premtuar e që e kemi kërkuar ka 4 vite , kanë thanë se do të vijnë dy kamion përmes prokurimit dhe njëri është për Komunën tonë por nuk ka ardhur. Dmth problemi kryesor këtu është te përzierja e kompetencave në mes AME-së dhe komunave. Pra ne po merremi edhe me do punë që nuk na takojnë, por e kemi bërë prej vullnetit të mirë dhe prej dhembshurisë që e kemi pas për zjarrfikësit ku ne i shohim çdo ditë dhe jemi bashkë me ta në kuadër të punëve dhe aktiviteteve që i bëjnë. Unë personalisht kam kërkuar nga Komandanti i Zjarrfikësve që të përgatisin listën për gjithçka që kanë nevojë, dhe ai ma ka sjellë listën e cila është proceduar. Pra është proceduar prej vullnetit tonë, jo prej përgjegjësisë që e kemi pas.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, kam një pyetje për Komandantin e Stacionit të Policisë, ndoshta e keni dhënë si informatë por të paktën nuk e kam. A ka pas persona të ndaluar, të dyshuar për zjarr vënie gjatë këtyre ditëve.

z. Bashkim Bajrami, theksoi sa i përket zjarreve ku edhe lexova si statistikë më herët 8 raste janë proceduar në prokurori, pra është fjala për persona të njohur për zjarr, kemi intervistuar por në mbajtje nuk ka qenë asnjë. Prej tyre 3 raste kemi të bëjmë me fëmijë nën moshën 14 vjeç. Fëmijët kanë qëndruar në grup, kanë pirë duhan dhe kanë shkaktuar zjarrin. 21 raste kanë mbetur në shënim zyrtar e që janë ende pjesë e hetimeve.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, besoj se personat që janë identifikuar ta marrin edhe dënimin të cilin e meritojnë pasi që kanë rrezikuar një pjesë të madhe të territorit të Komunës dhe jetën e njerëzve. Këtë vit kemi pas shumë zjarre, shpresojmë që vitet tjera të ngritët vetëdijesimi dhe të jemi më të kujdesshëm. Me që nuk ka diskutime tjera kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të Komunës

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fjalën e ka Drejtori i DSHPMSH z. Bahri Selimi,

z. Bahri Selimi, theksoi, kjo pikë është paraparë që të parashtrihen kërkesat për projekte konkrete në fushën e sigurisë publike pasi që jemi në fazën e përgatitjes së projekt buxhetit të Komunës për vitin që vjen. Është koha deri në fund të muajit shtator ku mund të përfshihet edhe ndonjë kërkesë e KKSB për ndonjë projekt në kuadër të buxhetit komunal. Në këtë kontekst sigurisht jeni të njohur se janë bërë dëgjimet publike për pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe subjekteve tjera. Kjo pikë është që edhe nga KKSB të marrim kërkesat të cilat kanë të bëjnë

me sigurinë publike dhe me mundësitë buxhetore të futen në projektbuxhetin për vitin e ardhshëm.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, e hap debatin për këtë pikë, fjala është e juaja.

z. Shemsi Jashari, theksoi, më vjen mirë që ka ardhur si pikë e rendit të ditës. Ka qenë një propozim konkretisht i imi më herët vitin e kaluar për të diskutuar për projektet nga aspekti i sigurisë. Unë mendoj që ky Këshill apo anëtar jo patjetër duhet të propozojnë projekte konkrete. Unë mendoj që duhet bërë e qartë se secili projekt duhet vlerësuar nga aspekti i sigurisë, çka ndikon ai projekt në sigurinë publike qoftë prej pozicionit ku vendoset, qasja në rrugë, trafiku, qasja e atyre që e shfrytëzojnë atë objekt, parkingu dhe të gjitha tjerat që ndërlidhen me institucione tjera, me objekte tjera. Për dhënien e një kontributi të madh si Këshill mendoj që ju duhet të na sillni listën e projekteve me lokacione ku keni vendosur për të ndërtuar ato projekte kapitale. Në momentin që ne ta kemi atë listë kemi mundësinë të japim kontributin tonë nga aspektimi i sigurisë sa mund të ndikojë ai investim në sigurinë publike duke i përfshirë elementet dhe destinimin për çka e ka. Duke ardh në këtë takim pashë se është filluar realizimi i projektit të pishinës në hyrje të qytetit, ndërsa është dashur trajtuar në aspektin e sigurisë para se të fillohet ai projekt, klientelën të cilën e ka, trafiku i cili do të shkaktohet me shfrytëzimin e atij objekti për destinimin që e ka, qasja në rrugë e atyre që e shfrytëzojnë atë objekt. Krejt kanë të bëjnë me sigurinë, në këtë kuptim nëse ju vendosni për të ndërtuar diçka në qytet ne kemi mundësi për të ta trajtuar duke shfrytëzuar ekspertizën e atyre që kanë ekspertizë, për ta trajtuar se sa mund të ndikoj në sigurinë e përgjithshme. Prandaj çka po propozoj unë është që para se të shkoj buxheti për miratim, edhe pse këtë vit është problem sepse është fushatë, nëse na e dërgoni listën e projekteve neve si anëtarë të Këshillit, por mos na sillni në mbledhje, sepse kështu ose duhet të ju dëgjojmë juve ose të lexojmë materialin, kështu që paraprakisht na sillni listën e projekteve ku mendoni ti bëni ato investime, atëherë ne mund t'i trajtojmë në aspektin e sigurisë dhe ti japim komentet tona, nëse ju e shihni të arsyeshme ti merrni parasysh kur tenderohet ai projekt për tu realizuar.

z. Bahri Selimi, theksoi, si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe ide që të marrim kërkesa nga ky Këshill. Meqë jemi në fazën e dëgjimeve publike edhe nga Këshilli dikush mund ta ketë ndonjë ide apo ndonjë kërkesë që do të kontribuonte në fushën e sigurisë publike, ndërsa sa i përket objektit që përmendët të pishinës gjysmë olimpike, këto ndërtime realizohen me projekt dhe në bazë të projektit parashihet edhe siguria, sepse në projektim ka edhe ekspert të sigurisë. Kur të bëhet projektimi ekspertët e sigurisë gjithsesi janë të përfshirë, e kjo vlen edhe për siguri publike por edhe për siguri të objektit. Ngjashëm është vepruar edhe për objektin e emergjencës i cili është afër objektit të pishinës. Në kushte të njëjta të ndërtimit në aspektin e sigurisë publike do të bëhet edhe ndërtimi i objektit të pishinës, sepse rruga nacionale është afër aty dhe domosdo duhet bërë siguria e rrugës dhe qasja në objekt bëhet në pjesën nga prapa tij. Kjo është bërë nga ekspertët e fushës, mirëpo prapë se prapë nëse dikush mendon apo ka ndonjë ide që kontribuon në ndonjë projekt apo ndonjë kërkesë që ne pa hezitim duhet ta përfshijmë në kornizën buxhetore 2026 edhe pse secili projekt ka një siguri në vete. Ne kemi bërë dëgjimet publike por janë duke vazhduar ende.

z. Shemsi Jashari, po dëgjime publike me 5 persona.

z. Bahri Selimi, nëse kanë qenë 5 persona në takim për dëgjim buxhetor pse ti nuk ke ardhur e të jesh i 6-ti dhe të na japësh aty një propozim.

z. Shemsi Jashari, çfarë dëgjimi publik është vjen e më thua i kemi 12 mil. Euro buxhet dhe çfarë më thoni të bëjmë me to, ajo është hajgare. Ti si ke bërë publike për atë zonë çka ke investuar në 4 vitet e fundit, për ta ditur unë se çka keni në plan, projektet që zgjasin 2-3 vite, se ky projekt ka fillua ndërtimin dhe për ta ditur unë si qytetar, për të qenë i informuar, jeni duke

bërë hajgare, e keni problem për ta kuptuar se çka është aspekti i sigurisë i një investimi kapital. Po kthehem prapë te pishina, a do të ishte më mirë të ndërtohet më në periferi diku, jo në rrugë kryesore, në rrugë ndërkombëtare, sepse ka pas hapësira tjera, sepse ai që shkon në pishinë e ka hapësirën e mjaftueshme edhe për parking, pastaj edhe pa shkaktuar tollovi në qytet, me na bllokuar qasjen, fjala vjen unë kur të vij në Emergjencë, pra në këtë kuptim po flas. Në aspektin e sigurisë ka pas mundësi për ta tërheq më brenda në një hapësirë, jo patjetër në rrugën kryesore. Nëse kjo sështë vetëm formale për të diskutuar për këtë temë, nëse doni përmbajtje dërgona listën e projekteve me lokacione, ne ua kthejmë me propozime, ndërsa ju prapë vendosni.

z. Bahri Selimi, theksoi, ju në fshatin Lluzhan kur është mbajtur dëgjimi buxhetor nuk ke ardhur për të qenë pjesë e atij takimi, sepse the që kanë qenë vetëm 5 persona, ndërsa ti nuk ke ardhur që të bëhesh i 6-ti, ndërsa këtu na thua dërgona listën e projekteve, ndërsa ne po kërkojmë ide në këtë takim, na jep ti iden ne e përfshijmë në projekt.

z. Shemsi Jashari, theksoi, unë jam anëtar i KKSB dhe nëse mua më trajton veç si një qytetarë atje, përderisa jam brenda këtij Këshilli e ke shumë gabim.

z. Bahri Selimi, theksoi, unë jam Drejtor, por jam qytetar mbi të gjitha.

z. Shemsi Jashari, këtu nuk po flasim në cilësinë e qytetarit, po flasim në cilësinë e zyrtarit, ti në këtë rast je duke fol në cilësinë e drejtorit e po ashtu unë jam duke folur në cilësinë e anëtarit të KKSB-së. Nëse doni përmbajtje, dërgona listën dhe i pranoni komentet, nëse nuk doni vazhdoni, askush nuk ju ndalon. E keni një propozim konkret te shkolla në hyrje të qytetit bëni hapësirat e parkingjeve sikurse që janë te shkolla “ Naim Frashëri”, ku mund të parkojnë kerret nënat me fëmijë për një kohë fjala vjen 15 min deri sa ta merr fëmijën apo ta lërë, pra veproni sikur te shkollat tjera, ka hapësira, kjo drejtpërdrejtë ka të bëjë me sigurinë. Një nënë e re që ka me sjellë fëmijën në shkollë me veturë atë veturë e ndal polici dhe e dënon apo atë e largon nga aty për shkak të bllokimit të rrugës. Pra bëni parkingjet për ndalesë të përkohshme, trotuaret të bëhen me barriera që veturave tu pamundësohet parkingu në to, projekt më të madh ti nuk mund të bësh për qytetin, e që deri më sot nuk është bërë, dmth është kaq e thjeshtë. Këto dy gjëra bëni dhe je në rregull. Nuk të them se do të jap votën por mund të them se e bën një punë të mirë.

z. Qefser Behrami, theksoi, kam një pyetje për Drejtorin, a i ka zbatuar të gjitha projektet e parapara për vitin 2025, nën dy, ne po japim propozime duke iu referuar kërkesave të banorëve të fshatrave që unë i përfaqësoj, por sido që të jetë ato të mbesin në ndërgjegjen e tyre se a do të kryhen apo jo. Tash kam dy propozime, te shkolla e Kërpimehut është një gjendje jo e mirë për parkingje dhe këtë e kam kërkuar shumë më herët, kërkesa tjetër është për sistemin e kamerave, vendosjen e tyre, kërkesë të cilën e kam parashtruar edhe më herët. Janë të nevojshme kamerat sepse rruga që shpie për në Bajgorë apo Mitrovicë është shumë e rrezikshme sepse në atë rrugë qarkullon gjithçka, ndodh që edhe kontrabanda bëhen. Pra mund të them se ka projekte që janë realizuar por jo të gjitha. Çerdhja është projekt i mirë që është realizuar dhe i ka dhënë pamje të mirë mjedisit, e po ashtu një punë e mirë është bërë me largimin e atyre mbeturinave.

z. Shefki Selmani, theksoi, kam një pyetje për Drejtorin e Infrastrukturës dhe urbanizmit, disa pengesa për t'i vendosur në rrugën “ Skënderbeu” afër lagjes së Cakiqëve, a është marr ndonjë vendim lidhur me këtë çështje, sepse kohën e fundit është goditur nga vetura një grua aty, si rezultat i shpejtësisë së madhe, po ashtu edhe profa Nuhi ka bërë kërkesën për trotuar në zonën e Orllanit te ura, a ka diçka apo ndonjë vendim lidhur me këtë. Gjithashtu kam edhe një kërkesë për vendosjen e një hapësire për parking te shkolla “ Naim Frashëri”, këtë po mendoj për persona me nevoja të veçanta ku mund të parkojnë veturat për transportin e personave me aftësi të veçanta, ose konkretisht Hendikos-i nëse do të kishte pas mundësi të vendosej një tabelë e madhe aty, pra kërkoj të bëhet një parking vetëm për këta persona me aftësi të kufizuara, ose thjesht për Hendikosin i cili i bartë fëmijët me nevoja të veçanta.

z. Nuhi Selimi, theksoi, asnjëherë nuk kemi paraqitur projekte si kryetarë të fshatrave por kemi paraqitur projekte të rëndësishme për çështje të sigurisë. Në Orllan sa e sa herë janë bërë kërkesa prej KLSB-së, ndërsa unë vetëm se i kam paraqitur kërkesat e tilla e jo të miat personale. Kërkesa, shtrohet pyetja a duhet çdo takim të përsërisim, apo duhet trajtuar seriozisht këto edhe mos të merremi më me to. Si kërkesa kemi pas çështjen e kamerave të sigurisë, pastaj të pengesave në rrugë, trotuarit te ura e Orllanit, mbeturinave rreth Liqenit, guri i madh te Restoranti Adriatik, në kthesë që paraqet rrezik permanent dhe janë edhe shumë të tjera, ku edhe unë si parashtrues i tyre mendoj se jam bërë i tepërt në këtë aspekt, duke i përsëritur të njëjtat.

Konstatim

z. Shemsi Jashari lëshoi mbledhjen

z. Bahri Selimi, theksoi, te këto vendparkingjet që i theksoi edhe z. Shemsi Jashari, i cili lëshoi mbledhjen, si temë e rëndësishme, ne vetëm se kemi filluar dhe kemi me shkuar për krijimin e tyre në secilën hapësirë publike ku na jepet mundësia, por kjo nuk është ide e tij sepse kjo ka filluar si proces. Për vendosje të pengesave në rrugën "Skënderbeu" kemi pranuar atë kërkesë pasi që ndodhi ai aksident. Edhe pse nuk jam ithtar të vendosen pengesa në rrugë sepse rrugët e reja po dëmtohen dhe po prishen, mirëpo kemi marrë kërkesën dhe e kemi shqyrtuar menjëherë dhe besoj që sot do të vendoset nëse nuk e kanë vendosur ende. Do të jetë një pengesë e plastikës, jo sikurse ato që kanë qenë më herët. Projekti i trotuarit në Orllan, këtë e kemi biseduar edhe herën e fundit që është projektuar dhe tashmë është në fazën e lidhjes së kontratës dhe së shpejti fillon realizimi. Se sa janë zbatuar të gjitha projektet, ato që kanë qenë të projektuara janë zbatuar, një numër është duke u zbatuar dhe nuk jam në dijeni konkretisht se për cilat është fjala. Projektet në vazhdimësi, ato që projektohen edhe zbatohen. Për pengesa në rrugën Lluzhan-Orllan këtë e kemi biseduar disa herë se Komuna nuk është përgjegjëse as në kompetencë të saj vendosja e pengesave në rrugë regjionale dhe ajo rrugë është regjionale dhe sa për njoftim edhe për vendosjen e trotuarit dhe urën për lidhjen e atij trotuari është dashur të bëjmë kërkesë në Ministri madje Ministria pastaj na ka ndihmuar edhe me buxhet. Te trotuari te ura në Orllan aty ka dal një kosto tejet e madhe sepse duhet zgjeruar urën, por fatmirësisht Ministria na ka dhënë mbështetje dhe ky projekt kryhet këtë vit, sepse përndryshe si Komunë e kemi pas problem realizimin e tij për shkak të koston së madhe.

z. Qefser Behrami, theksoi, desha prapë të pyes Drejtorin se sa mund të shpresojmë për kërkesën për kamera të sigurisë të cilën e kam parashtruar por edhe për trotuar por edhe një kërkesë të kamotshme që Drejtori është në dijeni, kërkesë e cila në rrethana tjera sigurisht që ish marrë parasysh, po të kisha daj apo shok të luftës.

z. Bahri Selimi, theksoi, po më duhet të përsëris gjërat, në diskutimin e parafolësit dua të them se dajët i dua shumë e po ashtu edhe shokët e luftës i respektoj tej mase më shumë se të gjithë tjerët, por nuk bëj dallime në asnjë rast. Për projektet që i përmendi parafolësi, u jap një lajm se është lidhur kontrata e projektimit të lumenjve pra ka filluar faza e projektimit dhe po shpresojmë se nëse kryhet në planin dinamik që i ka 60 ditë, brenda këtij viti do të lidhet kontrata për ndërtimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve. Ky do të plete projekti më i madh në Komunën e Podujevës për rregullimin e shtretërve të lumenjve, për të cilën vlerë financiare u kam treguar edhe më parë. Ndërsa për te trotuari dhe kamerat e sigurisë, ne me kamerat e sigurisë jemi duke bërë zgjerimin e rrjetit sepse kemi kontratë edhe për zgjerim dhe për mirëmbajtje dhe po shqyrtojmë mundësinë e vendosjes, ndërsa për trotuar e theksova se jemi në procedurën e rregullimit të parkingjeve nëpër të gjitha shkollat, por kërkohet pak kohë sepse nuk ka buxhet për kryerjen e të gjitha atyre punëve por duhet gradualisht, pjesë pjesë të përfundoj secila, me prioritet janë shkollat e qytetit, pastaj për të vazhduar në pjesët periferike të qytetit.

Qefser Behrami, theksoi, në pjesën ku bëhet lidhja e lumit Llap me atë të Pakashticës, një muri që ka mbetur në gjysmë ndërtimi, ka ankesa prej banorëve se a ka mundësi të vazhdohet me përfundimin e murit mbrojtës.

z. Liman Zeqiri, theksoi, dua të lidhem në diskutimet e këtyre dy Drejtorëve dhe të parafolësit. Unë i përgëzoj të gjithë qytetarët dhe juve për punën, mirëpo kurrnjëherë nuk kryhen punët që i planifikojmë, sepse nuk ka fuqi dhe mundësi atë që e planifikon për ta realizuar. Drejtor dua ta them vetëm një thënie latine, pa keq kuptime, përsëritja , përsëritja, përsëritja, përsëritja , se gjithmonë në jetë është përsëritja, se gjithherë përsëriten gjërat dhe nuk mund të thuash se e kreuva, se kreuva, mund ta kryej, se nuk mund e realizon ; *Repetitio mater stidiorum est / Përsëritja është nëna e diturisë*, e ti je djalë i dijshtëm, veç vazhdo, respekt.

z. Aldi Blyta-FSK, theksoi, u diskutua për Shoqatën vullnetare të zjarrfikësve dhe më intereson të dijë a ka ndonjë objekt të caktuar të paraparë për shoqatën, për arsye se nëse ka ndonjë zjarr ku ata do të kishin pasur mundësi të kontribuojnë ose të paktën të kenë pajisjet e veta dhe objektin e vet prej të cilit do kishin mundur të jepnin kontribut të caktuar, nëse zjarrfikësit e qytetit do të ishin në intervenim në ndonjë rast tjetër.

z. Bahri Selimi, theksoi, Shoqata vullnetare e zjarrfikësve u formua në vitin e kaluar, ku sipas udhëheqësit të Shoqatës janë mbi 20 vullnetarë. Sikurse jeni në dijeni për të qenë pjesë e një ekipi për shuarjen e zjarrit duhet të paktën të kesh trajnimin themelor për shuarje të zjarrit dhe ne kemi bërë kërkesë në AME vitin e kaluar që këta vullnetarët të kryejnë trajnimin themelor për fikje të zjarrit, apo siç quhet trajnimi themelor për kërkim dhe shpëtim në kuadër të shkollës në Vushtri, mirëpo vitin e kaluar nuk e kanë kryer për arsye se nuk ka pas buxhet. Tashmë përmes emaili na kanë njoftuar se janë duke u përgatit për kryerjen e trajnimit për anëtarët e shoqatës vullnetare. Andaj duke marr përbazë këtë fatkeqësisht nuk kemi mundur t'i angazhojmë shumë, pasi që është një farë përgjegjësie angazhimi i tyre pa përfunduar trajnimet. Prej anëtarëve të Shoqatës së vullnetarëve 3 prej tyre janë të certifikuar më herët, kanë kryer trajnimin dhe të tjerët janë në pritje dhe ne mendojmë ti angazhojmë në punë dhe aktivitete të zjarrfikësve si vullnetarë apo edhe me pagesë nëse kërkohet, përmes një kontrate me AME-në.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, sa i përket projekteve në aspektin e sigurisë publike të cilat mund të futen në projektbuxhetin e Komunës për vitin 2026, ne veç se e kemi kaluar fazën e diskutimeve për KAB gjatë qershorit të këtij viti, ndërsa realisht diskutimet për projekt buxhetin 2026 do të mbahen ditëve në vazhdim. Kështu që ju kisha propozuar juve si KKSB që në ditët në vijim të paraqitni nëse keni ndonjë kërkesë në mënyrë që ta përfshijmë në projektbuxhet. Meqë nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë kalojmë në pikën e radhës.

6. Informatë për sigurinë në komunikacion dhe trajtimi i qenve endacak

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, fjalën e ka Drejtori z. Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi, siguria në rrugë është prioritet për mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së qytetarëve. Zonat më të rrezikshme në qytet dhe në fshatra janë kryesisht afër shkollave, në rrugë kryesore dhe kryqëzimeve.

Komuna ka ndërmarrë disa masa për sigurinë në komunikacion :

-Duke vendosur kamera të sigurisë në disa pika kritike të qytetit për monitorim më të mirë të trafikut dhe parandalimin e shkeljeve, sa për informim Komuna është përgjegjëse për vendosje të kamerave dh mirëmbajtjen e tyre, ndërsa Policia e Kosovës bën monitorimin e tyre. Disa pika që janë të vendosura kamerat e sigurisë janë: udhëkryqi i Kerpimehut, te rruga për Llapashticë, rrethi te Shqiponja, rrethi te qershiat, ne rrugen “Gryka e Llapit” (rruga për Merdare), në shesh (ne dy pika), në rrugën Afrim Zhitia, te shkolla Shaban Shala, te udhëkryqi pran Gjykatës, në

rrugën të QKMF, ne udhëkryqin të Zena (rr. Ali Ajeti), Te Interex, rruga Ali Ajeti , te qeshmja e Azemit, te rruga e Xhamisë (te banesat e Malsisë), ne rr, "Zahir Pajaziti", rr. "Xhemajl Mustafa", rr. "Enver Maloku", te parku i Pishave, te parku i Manchesterit.

Me një fjale kemi një mbulushmeri të konsiderueshme me kamera të sigurisë në pjesën urbane, ndërsa tash me kontratën e re do të bëjmë zgjerimin edhe në një pjesë periferike. Hap tjetër i ndërmarr sa i përket sigurisë në komunikacion janë: punime në infrastrukturë në disa rrugë të qytetit dhe fshatrave për përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës rrugore, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për menagjimin e Rrugëve për patrullime më të shpeshta, në pikat më të rrezikshme si dhe ne kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës me kontratat për mirëmbajtje të rrugëve, po flasim për rrugët të cilat menaxhohen nga Ministria, siç janë rrugët regjionale .

Hap tjetër është: Vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale duke përfshirë gjithë qytetin dhe shumicën e fshatrave, siç është rruga Lluzhan-Sharban, Svecël-Gërdoc. Pastaj planifikimin dhe ndërtimin e ndriçimit publik në rrugët ne te cilat janë shkaktuar incidente të shumta komunikacioni gjatë natës, kjo është bere me kërkesë edhe nga stacioni policor, dhe vet banorët; Rishikimin e planeve urbanistike për të siguruar rrugë më të gjera dhe më të sigurta për këmbësorët dhe biçiklistët, prandaj janë ndërtuar shtigje të veçanta për biçiklistë në rrugët kryesore të qytetit për siguri më të madhe. Rrugët që kanë shteg te veçantë për biçikleta janë: rr. Zahir Pajaziti, rr. Xhemajl Mustafa, rr. Afrim Zhitia, rr. Hakif Zejnullahu, si dhe në ndërtim e sipër është edhe rruga Vellezerit Frasheri në të dy anët.

Ndërsa sa i përket trajtimit të qenve endacak ne sikurse e kemi diskutuar çdo vit lidhim kontratë për trajtim të qenve endacak. Tashmë fatkeqësisht nuk mund të veprojmë duke u bazuar në Ligjin për mbrojtjen e kafshëve. Punët që përfshihen në trajtimin e qenve endacak janë; Zënia/kapja e qenve endacak dhe vlerësimi për gjendjen shëndetësore; Trajtimi (kontroll, ushqim, vaksionim, dehelmetizim, identifikim) i qeneve endacak; Kastrimi/Sterelizimi i Qeneve endacak; Hospitalizimi (72 ore); Lëshimi i Qeneve endacak në vendin e zënies, ky edhe është problemi më i madh i cili na paraqitet me personat të cilët kërkojnë tua heqim qentë kjo neve na shkakton më shumë telashe për faktin se përkundër shpenzimeve që bëhen me rastin e trajtimit të tyre Ligji na obligon që qenin duhet lëshuar në të njëjtin vend ku edhe është zënë; Zënia/kapja e qenëve endacak dhe vlerësimi për gjendjen shëndetësore dhe Eutanazia (kryerja e procesit të Eutanazisë, transporti dhe groposja) e Qeneve endacak që është procesi i fundit dhe zbatohet pas vlerësimit se ai qen paraqet rrezik edhe për qentë tjerë endacak por edhe për shoqërinë, pastaj bëhet groposja e qenit . Këtë vit kemi kontratë për trajtimin e rreth 350 qenve endacak. Deri më tani në bazë të një raporti të përgatitur nga menaxheri i kontratës i kemi 184 qen të trajtuar thuajse në të gjitha këto procese dhe i kemi 16 qen ku është përdor eutanazia. Kjo ishte e tëra , nëse dikush ka ndonjë pyetje mund të jap sqarimet.

z. Qefser Behrami, theksoi, kam një pyetje sa i përket qenve endacak, a mbikëqyret procesi i zënies dhe i lëshimit të qenit në vendin e njëjtë, sepse mua më duket por kam edhe fakte se numri i qenve veç se është duke u shtuar.

z. Bahri Selimi, theksoi, secila kontratë e cila lidhet ka menaxherin e kontratës dhe një mbikëqyrës të menaxherit dhe ka tre anëtarë të komisionit, që do të thotë në kontratë janë të përfshirë 5 persona të cilët merren me të gjitha këto procedura. Unë e theksova se i tërë procesi duke filluar nga kapja e qenit dhe të gjitha veprimet tjera deri në lirim të qenit në vendin e zënies kryhet përmes këtyre personave që përmenda. Sa i përket numrit nuk pritët të ketë shumë zvogëlim të numrit të qenve sepse të gjithë qenët që kapen duhet kthyer po të njëjtin vend, fjala vjen nuk mundemi një qen që është zënë në Pakashticë pas trajtimit dhe hospitalizimit ta lëshojmë në Orllan. Prandaj nuk vërehet shumë mungesa e qenve, mirëpo e mira e tërë kësaj është që qentë trajtohen dhe të paktën nuk paraqet rrezik apo helmim. Sa për sqarim eutanazinë e

bën mjeku në prani të Komisionit si dhe kryhen e veprimet tjera që i ceka. E përsëris në bazë të kontratës duhet trajtuar 350 qen në vit, deri më tani janë trajtuar 184.

z. Liman Zeqiri, theksoi, ajo që mua më interesoi është çështja e komunikacionit. Ne e dimë që Podujeva ka një territor bukur të gjerë 633 km², me 78 fshatra, 90,000 banor, e kur vijnë edhe emigrantët shtohet numri, sidomos në muajt korrik, gusht dhe shtator dhe jemi në dijeni se ata kanë emocione ndaj vendit, ku edhe vet kam qenë mërgimtar, dhe e aplikojnë një shpejtësi të vozitjes pak më të madhe. Nuk jam në dijeni në operative, por kjo është për Komandantin për të shtuar pak numrin e zyrtarëve policor. Duke marr parasysh edhe mungesën e trotuareve, por edhe infrastruktura rrugore nuk është si në perëndim, për të mos ndodhin aksidentet e kam fjalën, sepse ata janë të mirëseardhur, janë mërgimtarë, se falë atyre që na ndihmojnë neve sepse të gjithë kemi familjarë dhe i presim me gëzim, por edhe ata kanë dëshirën të kenë një pushim të rehatshëm dhe të mirë andaj edhe niveli i sigurisë për me qenë në nivel pak më të mirë. Komandanti mund të na tregojë gjatë këtyre muajve çka është në plan/projekt ta quaj për t'u realizuar. Çdo herë është mirë siguria për të qenë në nivel por së paku këta muaj të jetë më e ngritur, për shkak të fluksit të madh të bashkatdhetarëve.

z. Bashkim Bajrami, theksoi, kemi 3 plane operative në drejtim të pritjes së bashkatdhetarëve, si në trafik por edhe gjatë mbrëmjes kur dalin në masë të madhe, po ashtu edhe te vendkalimi kufitarë në Merdare kur krijohet kolonë e madhe e automjeteve, dhe po ashtu i kemi në konsideratë dhe për çka do nuk i shqiptojmë tiketa, por u tërheqim vërejtjen, por megjithatë për shkak të numrit më të madh të veturave ka ngritje edhe të shqiptimit të gjobave por edhe të aksidenteve, ku 20 % kemi ngritje të numrit të aksidenteve dhe ndërsa 27 % kemi ngritje të gjobave të përgjithshme.

znj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, theksoi, nëse nuk keni pyetje të tjera rreth kësaj pike kalojmë në pikën e fundit të Rendit të ditës.

7. Të ndryshme

znj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, theksoi a ka dikush nga ju ndonjë propozim apo ndonjë pyetje.

z. Nuhi Selimi, theksoi, unë dua të shtroj çështjen e pagesave të anëtarëve të KKSB-së për takimet e KKSB-së. Na keni premtuar se do të angazhoheni në funksion të rregullimit të kësaj çështjeje.

znj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, theksoi, lidhur me çështjen e pagesave për anëtarët e KKSB-së për pjesëmarrje në takime të KKSB-së e kemi marrë një model të komunës së Klinës, por si i tillë nuk po na përshtatet sepse aty parashihet të mbahen takimet pas orarit të punës. Meqë nuk ka të interesuar të tjerë, e përmbylлим këtë pikë.

Nënkyetarja e mbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. prot. 02-060/01-0043980/25

Podujevë, datë: 28.07. 2025



Nënkyetarja e Komunës
Marigona Lahu